



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: data: 22.02.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 21.02.2022, të parashtruar nga **Grupi i operatoreve ekonomik Bujar Shabani B.I & Avag group shpk**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimi i rrugëve në lagjet Sillovi, Gadime, Smallushë, Gumnasellë, LLugaxhi dhe Babush**” me Nr. të Prok: 613-22-7225-5-1-1

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e **Grupi i operatoreve ekonomik Bujar Shabani B.I & Avag group shpk**, të dt. 21.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimi i rrugëve në lagjet Sillovi, Gadime, Smallushë, Gumnasellë, LLugaxhi dhe Babush**”, me nr. të Prok: 613-22-7225-5-1-1

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për **Grupin e Operatorëve Ekonomik Quality Asphalt SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM, Rr 2 Korriku, 70000, Ferizaj**. Mbetet në fuqi Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 16.02.2023.

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grupi i operatoreve ekonomik Bujar Shabani B.I & Avag group shpk, me datë 21.02.2023 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimi i rrugëve në lagjet Sillovi, Gadime, Smallushë, Gumnasellë, LLugaxhi dhe Babush**” me nr. të Prok: 613-22-7225-5-1-1 ku këtë aktivitet AK ka shpallur fitues **Grupin e Operatorëve Ekonomik Quality Asphalt SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM, Rr 2 Korriku, 70000, Ferizaj**, për shpërblim me kontratë të datës 16.02.2023 dhe ka publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Grupi i operatoreve ekonomik Bujar Shabani B.I & Avag group shpk, me datë.
21.02.2023, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit
“**Ndërtimi i rrugëve në lagjet Sllovi, Gadime, Smallushë, Gumnasellë,
LLugaxhi dhe Babush**” Autoriteti Kontraktues, me datë 22.02.2023, ka shqyrtuar
kërkesën në fjalë si më poshtë:

Ne baze të vendimit të OSHP-se PSH.Nr.525/22 të datës: 28.12.2022, kjo lëndë është
kthyer në rivlerësim dhe është kërkuar nga AK që të kërkojë sqarime shtese për të
vertetuar saktësisht se operatori ekonomik ankues i plotëson apo jo kërkesën e AK-se të
vendosur tek Kapaciteti teknik dhe profesional pika r. *Makine gjysmerimorkio speciale për
vendosje të bankinave për rreth rrugëve (1 cope).*

Ne kemi kërkuar sqarime nga operatori ekonomik ankues për këtë makineri, gjithashtu kemi
kërkuar sqarime edhe tek Qendra e regjistrimit të automjeteve të komunës së Ferizajit, të
cilat n'a kanë bashkangjitur dokumentet me të cilat ky operator është paraqitur për
regjistrimin e këtij mjeti, ku në Faturë shkruan: *Ky mjete nuk ka markë, tip dhe numer
serik*. Gjithashtu, n'a kanë paraqitur edhe Certifikatën mbi rregullsinë e automjetit dhe
Dudin doganor, ku shihet kështu që numri serik është në kundërtësi me këto dokumente: Në
certifikatë është S19500GH, ndërsa të dudu doganor është S 19/500-GH, dhe kjo n'a e
verteton që kjo makineri nuk e plotëson kërkesën e AK-se.

*Ne si autoritet kontraktues nuk kemi kërkuar asgjë më shumë se që kemi kërkuar në
Njoftim për kontratë dhe në Dosje të tenderit por neve n'a mundësohet që në bazë të Ligjit
të prokurimit për dilemat të cilat n'a paraqiten gjatë vlerësimit të ofertave të kërkojnë
sqarime shtese për të vertetuar gjendjen faktike dhe për këtë e kemi edhe rekomandimin e
OSHP-se. Është fakt që kërkesa e FDT-se është deshmi: Librezë e paisjes, të cilën OE e
ka ofruar por për shkak të mospërputhjes së përshkrimit në Libreze dhe Vendimit të
OSHP-se për t'i sqaruar këtë deshmi, pasi i ka sqaruar AK ka vlerësuar që OE nuk e ka
plotësuar kërkesën e FDT-se.*


AK, konsideron se tenderi juaj është vlerësuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri
rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë
OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.

Bekim Shabani


Drejtor i Prokurimit